



## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: 400/01-21484, dt. 17 Prill 2025.

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjën në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenit 4, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe 14 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – ish Zyret e QPS-së, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 17 Prill 2025, merr këtë:

### VENDIM

Nr. 16/2025

**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së, në afat prej tridhjetë e pesë (35) viteve sipas Vendimit Nr. 71-203 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024, me nr. Prot: 463-01/117215, dt. 28 Dhjetor 2023.

| PRONARI<br>Poseduesi | Nr. i<br>Ngastres | Emri i rrugës<br>(lokacioni) | Sipërfaqja | Zona<br>Kadastrale | Destinimi | Përiudha |
|----------------------|-------------------|------------------------------|------------|--------------------|-----------|----------|
| Komuna<br>Pejë       | 245-6             | Rr. Adem Jashari             |            | ZK Pejë            |           | 35 vite  |

- II. Pas plotësimit të kushteve ligjore dhe shpalljes së konkursit publik, komisioni për komunal për vlersimin e ofertave do të inicoj procedurën për zgjedhjen e ofertes më të favorshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së, në afat prej tridhjetë e pesë (35) viteve.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlersuesë, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

- IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

*Vendimi ti dërgohet:*

*MAPL-së,*

*Kryetarit të Komunës,*

*DÇPJ,*

*Arkiv.*

